



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 122 prot.

Kamëz, më 23.09.2024

V E N D I M
Nr. 92 .Datë 23.09 2024
M B I

**“MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA
ADMINISTRATORET SHOQËRORË PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-
NDIHMËS EKONOMIKE”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 23.09.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.70 Datë 19.09.2024 në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pika 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, në ligjin 57. datë 18.07.2019 “Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, VKM – në nr.956, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore” Kreu IV, pika 2 të Vendimit nr. 955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” të ndryshuar kreu IV, pika 3, Vendim 868, datë 29.12.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 597 datë 04.09.2019 dhe në VKB nr. 7 datë 22.01.2024 “Mbi miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike gjatë vitit 2024 për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit”, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së muajit **Gusht 2024**, prej **56** familje që janë rekomanduar nga administratorët shoqëror për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike.
Fondi për këto familje është **352,301 (treqind e pesëdhjetë e dymijë e treqind e një) lekë.**
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij projekt-vendimi paraqitet në relacionin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

